
Etleva Dyrmyshi
Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe
Shanseve të Barabarta
Drejtoria e Politikave Migratore, Kthimit dhe
Reintegrimit

Emigrimi shqiptar në konteksin e politikave ndërkombëtare

- Kofi Anan: "Asnjë prej nesh nuk i zgjidh i vetëm problemet e migrimit, por ama secili prej nesh mban në dorë një copëz të zgjidhjes së rebusit. Ka ardhur koha që t'i sjellim bashkë"***
 - Politikat e migrimit ndërkombëtar nuk ekzistojnë si të izoluara, të gjitha kanë pasoja globale***
 - kostot dhe përfitimet e migrimit nuk ndahen në mënyrë të barabartë, mes vendeve, por edhe as mes grupeve sociale***
 - Në politikat tona zë vend parësor bashkëpunimi dhe bashkërendimi ndërkombëtar.***
-

Emigrimi modern shqiptar

- Në periudhën e tranzicionit, që nga viti 1990, nga regjimi totalitar drejt demokracisë, Shqipëria ka përjetuar një ecuri emigratore me shumë kthesa dhe ndryshime***
 - probleme që meritojnë shikim të veçantë: “brain drain”, kontrabandimi dhe trafikimi i qenieve njerëzore, dërgesat e emigrantëve, rikthimi me dëshirë i shtetasve shqiptarë emigrantë, lëvizjet e ligjshme dhe të paautorizuara për arsye ekonomike.***
-

Tre periudhat e emigrimit modern shqiptar

- flukse emigratore, para vitit 1944;***
 - një diasporë më e vonshme, në përmasa të vogla, që emigroi në harkun kohor 1945-1990;***
 - flukse të konsiderueshme të pas viteve 1990-të, apo rrëzimit të regjimit komunist totalitar***
 - (i) flukse emigratore të harkut kohor 1991-1992***
 - (ii) flukset 1992-1996***
 - (iii) flukset e pas 1996-07***
-

Vështrim fotografik mbi emigrimin shqiptar

- Shqiptarët janë një ndër grupet më të mëdha të shtetasve të vendeve të treta në BE. Ata përbëjnë grupin e tretë me 0.8 milionë.***
 - Rreth 1 milion emigrantë nga një popullsi e përgjithshme 3.4 milionë banorë;***
 - 22-25% e popullsisë së përgjithshme;***
 - 35% e popullsisë aktive;***
 - flukset emigratore shqiptare 5-6 herë më të larta se sa ato krahasuese në vendet në zhvillim, lidhur me popullsinë aktive.***
-

Numri i emigrantëve shqiptarë në botë

<input type="checkbox"/> <i>Greqi</i>	600.000 [1]
<input type="checkbox"/> <i>Itali</i>	401.900 [2]
<input type="checkbox"/> <i>Shtetet e Bashkuara të Amerikës</i>	150.000
<input type="checkbox"/> <i>Mbretëri e Bashkuar</i>	50.000
<input type="checkbox"/> <i>Gjermani</i>	15.000
<input type="checkbox"/> <i>Kanada</i>	11.500
<input type="checkbox"/> <i>Belgjike</i>	5.000
<input type="checkbox"/> <i>Turqia</i>	5.000
<input type="checkbox"/> <i>Francë</i>	2.000
<input type="checkbox"/> <i>Austri</i>	2.000
<input type="checkbox"/> <i>Zvicër</i>	1.500
<input type="checkbox"/> <i>Vendet e Ulëta</i>	1.000
<input type="checkbox"/> <i>Totali =</i>	1.244.000

[\[1\]](#) *Strategjia Kombëtare e Migracionit, Tiranë, 2004.*

[\[2\]](#) *Rezultojne kaç ne 1 janar te 2008-s. Botim Caritas Immigrazione 2008.*

***Qendra e Studimeve per Emigracionin, Tirane, 2005
ka arritur ne keto perfundime nga intervistat e kryera:
Vendet më të preferuara për të emigruar si me poshte vijon:***

<u>Prioritetet</u>	<u>1992</u>	<u>1995</u>	<u>2005</u>
1	Itali	SHBA	SHBA
2	Gjermani	Itali	Kanada
3	SHBA	Gjermani	Itali
4	Zvicër	Australi	Britani e Madhe
5	Australi	Zvicër	Gjermani
6	Francë	Francë	Francë
7	Greqi	Britani e Madhe	Zvicër
8	Britani e Madhe	Greqi	Greqi
9	Kanada	V. Skandinav	V. Skandinave
10	Vendet Skandinave	Vende të tjera	Vende të tjera

Shkaqet kryesore të emigrimit të shtetasve shqiptarë.

- paga më të larta,***
 - mbështetja financiare e familjes,***
 - kushte më të mira pune,***
 - kushte më të mira jetese,***
 - kushte më të mira arsimimi për vete apo për pjestarët e tjerë të familjes, si edhe***
 - për shkak të sigurisë në vend në periudha të caktuara.***
-

Një studim i bankes boterore i vitit 2007 shohim se mbeten ende si përcaktues të migracionit ndërkombëtar;

- përqindja e individëve në moshë aktive pune. Individët në moshë pune janë më të prirur të emigrojnë;***
- mungesa e të ardhurave;***
- ngjarje, ose kriza ekonomike që sjellin pasoja në ekonomitë individuale (rasti skemave piramidale)***
- papunësia...etj***

Në përfundim, shohim që faktorët dhe arsyet ekonomike janë ato që detyrojnë shqiptarët të emigrojnë.

Perberesit kryesore te fluksit migrator ishin:

- individet qe emigruan ne kerkim te nje pune e jete me te mire;***
 - individet qe emigruan per motive politike dhe qe formuan kontigjentet e pare te refugjateve dhe azilkerkuesve shqiptare;***
 - individe qe emigruan per shkak te lidhjeve te tyre familjare, etnike ose fetare me zonat pertej kufirit, sidomos ne Greqi, dhe ne raste me te rralla edhe ne Itali;***
-

-
- individë që emigruan për motive shkollimi dhe që ishin pararendesit e flukseve migratore studentore;**
 - individë që emigruan nga vendi i tyre thjesht nën veprimin e faktoreve tërheqës, joshjes prej jetës në Prënedim, por pa ndonjë projekt të qartë migrator;**
 - fëmijë që ndoqen në emigrim prindërit e tyre, të cilët emigruan kryesisht për motive punësimi;**
 - fëmijë të pashoqeruar.**
-

Politikat shtetërore të emigrimit

- Shteti shqiptar menaxhon emigrimin e shtetasve shqiptarë, duke e vlerësuar atë si një zgjedhje të individit dhe në respekt të lirisë së lëvizjes së lirë të shtetasve.***
 - Autoritetet shtetërore përgjegjëse krijojnë lehtësi ligjore dhe administrative, të nevojshme për shtetasit shqiptarë, që dëshirojnë të emigrojnë në mënyrë të ligjshme ose që dëshirojnë të rikthehen.***
 - Autoritetet shtetërore përgjegjëse krijojnë lehtësi ligjore dhe administrative, të nevojshme për menaxhimin e emigrimit, nëpërmjet informimit periodik, publik ose individual, për situatën ligjore dhe ndryshimet që mund të jenë bërë në shtetet pritëse, për punësimin dhe formimin profesional.***
 - Autoritetet shtetërore përgjegjëse mbështesin punësimin ndërkufitar të shtetasve shqiptarë, nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve dypalëshe/shumëpalëshe, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore në fuqi.***
-

Autoritetet shtetërore përgjegjëse për migracionin e punës, kompetencat e tyre.

- Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta është autoriteti përgjegjës kombëtar, që harton politikat dhe propozon ndryshime në legjislacionin e fushës së emigrimit për qëllime punësimi***
 - Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të të Barabarta është autoriteti kryesor koordinues për zbatimin e ligjit për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi por dhe për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe planin e saj të veprimit.(sistemi i koordinimit dhe monitorimit)***
-

-
- ❑ ***MPCSSHB përmes Drejtorisë së Politikave të Punësimit, e cila harton politika për punësimin dhe formimin profesional lehtëson punësimin e shtetasve që kthehen nga emigracioni si edhe riformim profesional te tyre. Gjithashtu perfshin dhe formim profesional per shtetasit shqiptare para nisjes në emigracion.***
 - ❑ ***Shërbimit Kombëtar të Punësimit, institucion varesie i MPCSSHB, permes sektorit te emigracinit dhe marredhenieve te punes zbaton politikat shteterore ne fushen e migracionit. Ky sektor mbeshtet sektoret e Zyrave Vendore dhe Rajonale te Punesimit (regjistrin e emigranteve, sportelet e migracionit)***
-

-
- ***Ministria e punëve të Jashtme mbron të drejtat dhe interesat e emigrantëve shqiptarë përmes përfaqësive diplomatike dhe konsullore në vëndet e destinacionit***
 - ***Mbledh dhe shpërndan informacion për legjislacionin e punës dhe të mbrojtjes shoqërore, për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve emigrantë si edhe harton dhe përcakton programe bashkëpunimi me komunitetet emigratore shqiptare;***
-

-
- ***Ministria e Brendshme ushtron kontrollin e kufijve, për të siguruar emigrimin e rregullt të shtetasve shqiptarë,***
 - ***Marrjen e masave për parandalimin dhe çrrënjosjen e trafikimit të qenieve njerëzore si edhe trajtimin me përparësi për pajisjen me dokumentacionin e nevojshëm të shtetasve shqiptarë që kërkojnë të emigrojnë;***
-

-
- ***Ministria e Arsimit dhe Shkencës bashkëpunon me autoritetet përgjegjëse të shteteve pritëse për ngritjen e qendrave arsimore dhe kulturore shqiptare në këto vende për krijimin e kushteve lehtësuese për arsimimin e fëmijëve të emigrantëve;***
 - ***zbatimin e programeve të përbashkëta me institucionet vendase dhe të huaja për rikthimin vullnetar të studentëve të arsimuar dhe të kualifikuar jashtë vendit si edhe bashkëpunimin me autoritetet përgjegjëse të shteteve pritëse për njohjen e diplomave dhe të kualifikimeve***
-

-
- ***Instituti i Sigurimeve Shoqërore (në varësi të Ministrisë së Financave), i cili negocion me homologët e tij në vendet pritëse për hartimin e nënshkrimit e marrëveshjeve të sigurimeve shoqërore.***
 - ***Instituti i Statistikave (INSTAT) mbledh dhe shpërndan të dhënat e studimeve që ndihmojnë në krijimin e një kuadri më të qartë të dukurisë së migracionit.***
-

Sintezë e politikave migratore të qeverisë shqiptare

- politika të tregut të punës, duke i dhënë prioritet formimit profesional, duke njohur natyrën përzgjedhëse të migrimit të sotëm, njëherësh duke u kujdesur që ky treg të mos pësojë përkeqësime artificiale me largimin e më të përgatiturëve;***
 - politika të mbështetjes së integritit ekonomik-social të migrantëve në vendet pritëse në bashkëpunim me qeveritë dhe shoqëritë e këtyre vendeve;***
 - politika të bashkëzhvillimit të vendit tonë, duke mbajtur parësor binomin migrim-zhvillim;***
 - masa dhe ndërhyrje për të nxitur dhe mështetur rrjetet e diasporës së re dhe të vjetër;***
-

Sintezë e politikave migratore të qeverisë shqiptare

- mbështetja e migrimit dhe përmasave të dërgesave, të përfshira në strategjitë e zhvillimit të vendit, sidomos në strategjitë e uljes së nivelit të varfërisë;***
 - mbështetje financiare dhe teknike për organizatat dhe rrjetat e migrantëve, përmes politikave të bashkëzhvillimit, duke mobilizuar aftësitë dhe kapitalet e tyre njerëzore, financiare dhe sociale në të mirë të zhvillimit të vendit, përmes kthimit të tyre fizik dhe virtual;***
 - masa për të parandaluar dhe çrrënjosur migrimin e parregullt, kontrabandimin dhe trafikimin e qenieve njerëzore; përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor, përmes ratifikimit të marrëveshjeve dy a më shumëpalëshe.***
-

Ju falenderoj per vemendjen
